

## Angazhimi serb në politikën e Kosovës

### Hyrje

Këshilli për Qeverisje Inkluzive (CIG), më 24 qershor ka organizuar në Beograd një tryezë të rrumbullakët për përfaqësuesit e partive të serbëve të Kosovës, partive të Serbisë, zyrtarëve qeveritarë të Serbisë, dhe një numër analistësh serbë. Qëllimi i tryezës ka qenë adresimi i çështjes së rolit të serbëve të sapozgjedhur të Kosovës në institucionet qendrore të Kosovës, dhe eksplorimi i mënyrave se si mund të ndihmojnë përfaqësuesit serbë në tejkalimin e pengesave në nivelin lokal, posaçërisht në veri.

Tryeza e rrumbullakët është pjesë e projektit për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi, dhe integrimin e veriut të Kosovës. Projekti financohet nga Departamenti Federal Zvicrran i Punëve të Jashtme.

Serbët e Kosovës në veri kanë marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare të Kosovës për herë të parë qysh kur Kosova shpalli pavarësinë në vitin 2008. Në kuadër të kornizës së tanishme ligjore, serbët e Kosovës i kanë të garantuara 10 ulëse në parlament, dhe kanë të drejtë të udhëheqin me dy ministri, nëse qeveria e Kosovës ka më shumë se 12 sosh. Qeveria e kaluar ka punuar me 19 ministri. Nëse numri i ministrive është më i ulët se 12, atëherë serbët e Kosovës kanë të drejtë ta kenë një post ministror. Iniciativa qytetare Srpska Lista ka fituar nëntë nga 10 ulëset e garantuara në zgjedhjet e qershorit, dhe këtu përfshihen edhe disa anëtarë të Partisë së Pavarur Liberale, e cila ka qenë pjesë e qeverisë me tri ministri në mandatin e kaluar. Ulësja e mbetur ka shkuar tek Partia Progressive Demokratike.

Lista Srpska ka përkrahjen e qeverisë së Serbisë dhe pritet që të veprojë në koordinim të afërt me Beogradin. Disa e shohin këtë përkrahje si një kontribuues në përmirësimin e interesave të serbëve të Kosovës. Megjithatë, një numër folësish kanë thënë se frikësohen se Beogradi para së gjithash do t'i inkurajojë deputetët e rinjë që të ndjekin interesat e shtetit të Serbisë për të “minuar dhe refuzuar institucionet e Kosovës”, dhe vetëm pasi ta ketë bërë këtë, të merret me çështjet që i brengosin serbët e Kosovës. Për më shumë, ata janë të shqetësuar se “përplasjet e vazhdueshme në institucione do ta ngrisin nivelin e përgjithshëm të tensioneve mes serbëve e shqiptarëve, duke i lënë në hije çështjet reale, dhe duke i bërë serbët të duken si ngatërrestarë”. Partitë e shqiptarëve të Kosovës e shohin Listën Srpska më një dozë dyshimi dhe shumë prej tyre e quajnë atë “Kali i Trojës”. Në këtë kuptim, shumica e folësve kanë thënë se “beteja” mbi çështjet nacionale duhet të luftohet nga Beogradi, kurse përfaqësuesit politik të serbëve të Kosovës do të duhej të merreshin ekskluzivisht me çështjet e komunitetit serb në Kosovë.

## **Lista Srpska – Bashkëpunim apo refuzim**

Qëllimi i deklaruar i Beogradit gjithmonë ka qenë fuqizimi i komunitetit serb në Kosovë, dhe, sipas një folësi, dialogu i Brukselit ka qenë kryesisht për interesat e serbëve të Kosovës. Një folës i njohur me politikën e Beogradit në raport me Kosovës ka thënë se Beogradi do të vazhdojë të dialogojë me Prishtinën rreth çështjeve të telekomunikimit, energjisë, si dhe gjyqësorit në veri, me qëllimin kryesor që të përmirësojë jetën e serbëve të Kosovës. Ai ka konfirmuar se Beogradi nuk do ta zvogëlojë përkrahjen politike e financiare për serbët e Kosovës. Në lidhje me incidentet e fundit që pasuan ndërtimin e “parkut” në urën e Mitrovicës, një folës e ka fajësuar Prishtinën dhe komunitetin ndërkombëtar për ekzagjerimin e çështjes. “Nuk është e kuptueshme pse Uashingtoni dhe Brukselit janë duke folur për parkun, sikur ky të ishte problemi kryesor në Kosovë”. Ai ka thënë se Lista Srpska do të veprojë si një trup i bashkuar në institucionet e Kosovës, dhe do të vendosë një numër objektivash të cilat dëshiron ti arrijë gjatë mandatit të saj. Ai poashtu ka thënë se Lista Srpska do të ketë një pozicion më të rreptë se sa grupet e kaluara serbe në institucionet e Kosovës.

Menaxhimi i Beogradit të Listës Srpska, nga një numër i folësve të serbëve të Kosovës është konsideruar si një hap prapa në procesin e demokratizimit përbrenda komunitetit serb në Kosovë. Serbët e Kosovës në të kaluarën kanë formuar në mënyrë të pavarur një numër partishë politike, kanë zhvilluar kapacitetet për fushata demokratike, kanë konkurruar në procesin zgjedhor dhe, edhe pse në lista të ndara, ia kanë dalë të vendosin një bashkëpunim efikas në parlament. Një folës i njohur me partitë politike të serbëve të Kosovës ka thënë se pas gjithë këtij përparimi, brenda vetëm disa javësh, Lista Srpska e ka minuar gjithë progresin e viteve të kaluara.

Ankesa kryesore ka qenë se Lista Srpska është një zgjatim i Lëvizjes së Socialistëve, një parti e vogël e Serbisë e udhëhequr nga ministri i Serbisë Aleksandar Vulin, duke qenë se pesë nga nëntë anëtarët e parlamentit nga Lista Srpska janë anëtarë të kësaj partie politike. Sa i përket votimit në veri të Kosovës, disa folës kanë thënë se ka qenë një mashtrim total. “Votuesit kanë votuar për ata për të cilët Beogradi ka vendosur ti zgjedhë. Në fakt këta njerëz nuk janë zgjedhur; ata janë caktuar”. Ky folës ka shtuar se “votimi i refugjatëve në Serbi ka qenë katastrofal: një person ka mbushur mbi 10 mijë fletëvotime me lapsin e njejtë, duke u dhënë votën vetëm pesë njerëzve, të gjithë të partisë së Vulinit”.

Disa folës kanë thënë se një listë e përbashkët mund të jetë e dëshirueshme në kontekstin e tanishëm, por kanë pasur ankesa rreth qasjes së Beogradit për të “mikromenaxhuar çdo aspekt të fushatës”, përfshirë edhe përpilimin e listës së kandidatëve pa konsideruar asnjë “kriter demokratik”. “Është mirë ta kemi një listë të përbashkët në këto rrethana, por poashtu duhet ti definojmë qëllimet të cilat na bashkojnë dhe nëse njerëzit në këtë listë mund të kontribuojnë në këto qëllime. Një listë etnike nuk është e mjaftueshme për përmirësimin e jetës së komunitetit serb. Në këtë drejtim nevojiten profesionistët”, ka thënë një folës. Ai ka shtuar se nuk ka garanci se 10 anëtarët e zgjedhur të parlamentit nga serbët e Kosovës do t'i ndjekin qëllimet e përbashkëta dhe se do të jenë të aftë të

arrijnë shumë, duke qenë se shumica prej tyre kanë mungesë të përvojës në politikë në përgjithësi, dhe në punën më institucionet e Kosovës në veçanti”. Për më shumë, këtë grup njerëzish nuk e bashkon asgjë tjetër përveç përkatësisë etnike. Ata nuk kanë qëllime të përbashkëta apo një strategji për ti arritur ato. Si e tillë, Lista Srpska nuk e përfaqëson forcën autentike të serbëve të Kosovës, gjë kjo e cila ka qenë qëllim i shume serbëve të Kosovës gjatë gjithë këtyre viteve.

Një numër i folësve serbë të Kosovës u kanë rekomanduar zyrtarëve në Beograd që të mos e përdorin këtë grup njerëzish për interesat e ngushta të tyre. “Mos i shtyeni të luftojnë me shqiptarët e Kosovës; inkurajoni ata të vendosin bashkëpunimin dhe të veprojnë si një forcë për zgjidhjen e shumë problemeve të mbledhura gjatë viteve”. Folësit kanë thënë se bashkëpunimi është opcioni më i mirë, duke qenë se shqiptarët e Kosovës kanë shumicën absolute dhe se përveç ndryshimit të kushtetutës, ata mund të aprovojnë dhe implementojnë çfarëdo ligji pa serbët e Kosovës. Deputetët serbë të Kosovës, dhe ata të cilët janë duke udhëhequr dy ministritë, do të duhej të insistonin në implementimin e plotë të ligjeve të pakos së Ahtisaarit që kanë të bëjnë me komunitetin serb në Kosovë. Një folës ka raportuar se shqiptarët e Kosovës nuk kanë qenë të gatshëm ti implementojnë këto ligje dhe “janë të lumtur kur serbët e Kosovës e refuzojnë planin dhe merren me politika nacionale në vend se të merren me politika specifike”. Edhe kur interesat e serbëve të Kosovës përkthehen në akte ligjore, ato shumë rrallë implementohen në tërësi. Kjo ndodhë pjesërisht për shkak të angazhimit të pamjaftueshëm politik. Rrjedhimisht, komuniteti serb ka nevojë për një udhëheqës aktive të serbëve të Kosovës, të cilët fokusohen në politika, e jo në politikë.

Beogradi nuk duhet të ndërmarrë veprime të cilat tërheqin vëmendje, e që nuk i zgjidhin problemet me të cilat ballafaqohen serbët. Sipas disa folësve, në fakt, ato vetëm vënë nën hije çështjet kryesore. Një veprim i tillë ka qenë ndërtimi i “parkut” në urën në Mitrovicë. “Parku është një lojë fëmijësh. Parqet në urë nuk kanë kurrfarë kuptimi dhe nuk ekzistojnë askund në botë. Askush nuk përfiton nga kjo lojë, as edhe vetë krijuesit e kësaj loje”, ka thënë një folës. Ky folës ka thënë se krijuesit e “parkut” janë poashtu përgjegjës për keqpërdorimin e refugjatëve serbë, duke votuar në emër të tyre, për ti akomoduar “miqtë e tyre në parlamentin e Kosovës”. Ai poashtu ka kritikuar komunitetin ndërkombëtar që ka lejuar një mashtrim të tillë të ndodhë “në emër të integritit”. Një tjetër folës ka thënë se në njërin anë, ne kemi përfaqësimin më demokratik të shqiptarëve në parlamentin e Kosovës, dhe, në anën tjetër, përfaqësimin më jodemokratik të serbëve.

Një tjetër folës ka thënë se porosia e Beogradit është kundërthënëse: ai kërkon nga serbët e Kosovës të marrin pjesë në zgjedhjet e Kosovës me simbole të Kosovës, por tani kërkon nga serbët e Kosovës të zgjedhur, të refuzojnë krijimin e komunave për shkak të simboleve të Kosovës. “Ne jemi të hutuar; nuk dijmë çfarë të presim nga Beogradi. Beogradi nuk ka pasur një politikë konsekuente për një kohë shume të gjatë”. Një folës ka thënë se politikanët vazhdimisht janë duke krijuar geto, në vend se ta përmirësojnë integrimin. Është e rëndësishme të krijohet Komuniteti i komunave me shumicë serbe në Kosovë. Politikanët duhet të jenë realistë. Nuk do të jetë qeveri paralele në Kosovë, e as nivel paralel i pushtetit. Megjithatë, serbët e Kosovës ende munden të marrin diçka

thelbësore. Një rezultat i tillë varet nga serbët e Kosovës të cilët do të hyjnë në qeveri. Një nivel i autonomisë është pritje reale për Komunitetin.

Një folës ka thënë se thelbi i problemit në veri është se marrëveshja e Brukselit nuk është implementuar në terren. Një folës tjetër ka theksuar se ende nuk është dorëzuar ndonjë raport në parlamentin e Serbisë, në lidhje me implementimin e Marrëveshjes së Brukselit, dhe ka propozuar që qeveria ta përgatis një të tillë.

Një folës i cili ka qenë në listën e Lista Srpska, ka qenë i kënaqur me faktin se serbët e Kosovës janë të bashkuar në një forcë politike, por nuk ka qenë i kënaqur me rezultatin. “Nuk është mirë të kemi 5 anëtarë nga partia e Vulinit, dhe asnjë nga partia më e madhe në Serbi. Rezultati na ka hutuar më shumë se çdo gjë që ka ndodhur më parë”. Një tjetër folës ka thënë se jemi naivë, nëse mendojnë se Beogradi mund ta kontrollojë se kush e krijon qeverinë e Kosovës.

## **Vendosja e qeverisë lokale funksionale në veri**

Disa nga folësit kanë fajësuar Prishtinën dhe komunitetin ndërkombëtar për vonesat në formimin e institucioneve lokale në veri, kurse të tjerët kanë kritikuar poashtu zyrtarët e Beogradit për faktin se nuk janë konstruktiv në implementimin e marrëveshjes së Brukselit. Në përpjekje për ta dalë nga qorrsoaku, një folës ka propozuar krijimin e Komunitetit të komunave me shumicë serbë sa më parë që është e mundur. “Komuniteti do të ndihmonte koordinimin e përpjekjeve të serbëve të Kosovës dhe gjithashtu do të kompenzonte përfaqësimin e pamjaftueshëm të serbëve të Kosovës në institucionet qendrore të Kosovës”.

Edhe pse Beogradi është pajtuar me mbajtjen e zgjedhjeve lokale në veri dhe me zgjedhjet parlamentare të Kosovës, një folës ka thënë se këto zgjedhje kanë qenë “ilegale, jolegjitime dhe të padrejta” për njerëzit që janë zgjedhur. “Neve na është thënë se zgjedhjet janë neutrale ndaj statusit, por kur kemi shkuar të votojmë, simbolet e Kosovës kanë qenë në fletëvotime”. Ai ka thënë se zyrtarët e zgjedhur në veri janë nën presion të madh nga të gjitha anët: Prishtina, Beogradi dhe komuniteti ndërkombëtar, dhe të gjithë kërkojnë gjëra të ndryshme nga ta. “Ata nuk mund ti kënaqin të tre akterët, dhe nëse duhet të zgjedhin, ata do ta zgjedhin Beogradin”.

Një folës ka thënë se Beogradi duhet ta fuqizojë kapacitetin lokal të serbëve të Kosovës, në vend se të vazhdojë të “komandojë dhe kontrollojë” komunitetin. Koha ka treguar se qeveritë e kaluara poashtu kanë bërë gabime sa i përket politikave të tyre karshi Kosovës, dhe kjo qeveri duhet të mësojë nga gabimet e të kaluarës. Serbët në Kosovë duhet të fokusohen në fuqizimin e institucioneve të tyre dhe të ofrojnë shërbime më të mira për popullatën. Vetëm institucionet e fuqishme garantojnë një të ardhme të qëndrueshme për komunitetin.

Një tjetër folës ka thënë se sa më pak që është i përfshirë Beogradi në politikën lokale, aq më mirë. Beogradi nuk duhet të vazhdojë ta mikromenaxhojë politikën e serbëve të Kosovës; ai duhet thjesht të krijojë kushtet që ata të operojnë në mënyrë efektive. Ai ka

shtuar se koha kur është ndërtuar “parku në urë ka qenë e tmerrshme”. Kjo vetëm tregon se ata të cilët përgjegjës, nuk e kuptojnë realitetin e ri. Ai ka spekuluar duke thënë se disa në Beograd mendojnë se aneksimi i Krimesë nga Rusia, ka hapur rrugën për aneksimin e veriut, dhe kanë shpresuar se “parku” do të vënte në lëvizje një projekt të tillë.

Në përfundim, pjesëmarrësit kanë rekomanduar që autoritetet komunale ta zgjidhin çështjen e buxhetit, ta krijojnë administratën lokale, dhe të fillojnë të ofrojnë shërbime lokale. Autoritetet lokale do të duhej të merreshin ekskluzivisht me problemet lokale, të cilat janë të shumta në veri, dhe ta lënë vetëm Beogradin të merret me çështjet që kanë të bëjnë me statusin. Ata poashtu kanë rekomanduar që komunat të punësojnë më shumë menaxherë të kualifikuar që do të ndihmonin në implementimin e projekteve.

## Pjesëmarrësit

*Renditja sipas alfabetit të gjuhës angleze*

**Ksenija Bozovic**, Presidente e Asamblesë Komunale të Mitrovicës Veri  
**Gordana Delic**, Drejtor ekzekutiv, Fondi Ballkanik për Demokraci  
**Jelena Djokic**, Këshilltare e Kryetarit të Komunës së Zveçanit  
**Jelena Djoric**, Këshilltare e pavarur, Komisioni për Kosovë e Metohi, Parlamenti i Serbisë  
**Marko Djuric**, Drejtori i Zyrës për Kosovë e Metohi, Qeveria e Serbisë  
**Milovan Drecun**, Kryesues, Komisioni i Kosoves e Metohisë, Parlamenti i Serbisë, Partia  
Progresive Serbe  
**Bojan Elek**, Hulumtues, Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë  
**Natasa Elezovic**, Këshilltare e Kryetarit të Komunës Mitrovicë Veri  
**Marko Jaksic**, Analist, Mitrovicë e Veriut  
**Dusan Janjic**, Analist, Forumi për Marrëdhënie Etnike  
**Vesna Jovanovic**, Drejtore për Arsim, Shëndetësi, Mirëqenie Sociale, Rini e Sport, Komuna e  
Parteshit  
**Dusan Kozarev**, Asistent Drejtor i Zyrës për Kosovë e Metohi, Qeveria e Serbisë  
**Dragisa Krstovic**, Këshilltar i Ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal  
**Milivoje Mihajlovic**, Kryesues i Zyrës për Marrëdhënie me Media, Qeveria e Serbisë  
**Ljubisa Mijacic**, Analist, Zubin Potok  
**Petar Miletic**, Ish-nënkryetar, Parlamenti i Kosovës  
**Smiljka Milisavljevic**, Profesor, Universiteti në Mitrovicë  
**Zoran Ostojic**, Ish-anëtar i Parlamentit të Serbisë  
**Krstimir Pantic**, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Progresive Serbe  
**Dejan Radenkovic**, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Socialiste e Serbisë  
**Nenad Radosavljevic**, Drejtor i Bordit, Rrjeti i TV stacioneve serbe në Kosovë  
**Goran Rakic**, Kryetar i Komunës së Mitrovicë Veri  
**Branko Ruzic**, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Socialiste e Serbisë  
**Bojana Todorovic**, Këshilltar, Komisioni për Kosovë e Metohi, Parlamenti i Serbisë  
**Rada Trajkovic**, Ish-anëtare e Parlamentit të Kosovës  
**Jelena Trivan**, Drejtoreshë, Qendra për Politika dhe Vlera Evropiane  
**Janko Veselinovic**, Anëtar, Parlamenti i Serbisë, Partia e Re Demokratike  
**Shpetim Gashi**, Nënpresident, Këshilli për Qeverisje Inkluzive  
**Alex Grigorev**, President, Këshilli për Qeverisje Inkluzive  
**Igor Novakovic**, Bashkëpunëtor në Serbi, Këshilli për Qeverisje Inkluzive  
**Jean-Luc Oesch**, I ngarkuar me Punë , Ambasada e Zvicrrës në Serbi  
**Julien Stauffer**, Atashe, Ambasada e Zvicrrës në Serbi  
**Talia Wohl**, Zyrtare e Programit, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme i Zvicrrës